

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Besëlidhja Basket synon një tjetër sezon në nivele të larta, test miqësor me kampionët e Arabisë Saudite - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/beselidhja-basket-synon-nje-tjeter-sezon-ne-nivele-te-larta-test-miqeso-r-me-kampionet-e-arabise-saudite/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:53:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:50:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5b3394119ab8da655612e5cb9c68a9bae1d7f226573fb6c93df400510758aa25
TEKSTI	ee9089c978e8b762e4cb5636ee7ccc5229c70e1aedebc71412e09932c3498780
PAMJA	32b77b23bdf0f2f5885c5f347665faa0c073e05cfffce43257eabd1edf889ded

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d6fa8223ed42ddfb994e4ac66af952c5d5f40bf7381502f64b463d341bd8684d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d6fa8223ed42ddfb994e4ac66af952c5d5f40bf7381502f64b463d341bd8684d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Besëlidhja Basket synon një tjetër sezon në nivele të larta, test miqësor me kampionët e Arabisë Saudite

KRYESORE

Demo

Besëlidhja Basket synon një tjetër sezon në nivele të larta, test miqësor me kampionët e Arabisë Saudite

SEPTEMBER 17, 2026



Besëlidhja Basket vijon përgatitjet për sezonin e ri, pas performancave dhe rezultateve pozitive të arritura gjatë viteve të fundit, si në arenën kombëtare, ashtu edhe në atë rajonale.

Rritja e nivelit dhe ambiciet e klubit lezhjan kanë bërë që faza përgatitore të konceptohet me një seri ndeshjesh testuese ndaj kundërshtarëve të fortë, me synimin që skuadra të jetë në formën më të mirë për sfidat e sezonit të ri.

Një prej testeve më të rëndësishme do të jetë përballja ndërkombëtare me ALUla SC, ekipin kampion nga Arabia Saudite. Ndeshja miqësore është programuar për më 19 shtator 2026, ora 18:00, në Pejë, dhe përbën një mundësi të rëndësishme për stafin teknik për të matur nivelin e skuadrës përballë një kundërshtari të nivelit të lartë.

Për Besëlidhjen, përballje të tilla janë gjithashtu dëshmi e rritjes së klubit dhe e pozicionit që ai ka krijuar përmes rezultateve të viteve të fundit. Objektivi është që kjo ecuri të vazhdojë edhe në sezonin e ri, duke rritur më tej standardin sportiv dhe konkurrueshmërinë e skuadrës.

Rezultatet dhe progresi i Besëlidhjes janë fryt i një pune të përbashkët ndër vite, nga basketbollistët dhe stafi teknik, te drejtuesit e klubit, Bashkia Lezhë, sponsorët dhe të gjithë mbështetësit që kanë kontribuar në zhvillimin e ekipit.

Ndeshja me ALUla SC është një tjetër hap në këtë rrugëtim, ndërsa Besëlidhja kërkon të konfirmojë në sezonin e ri nivelin dhe ambiciet e saj, brenda dhe jashtë vendit.

aiula sc Arabi Saudite Basketboll beselidhja basket kampione

SHARE.



Postimet e reja

Besëlidhja Basket synon një tjetër sezon në nivel...

SEPTEMBER 17, 2026

Pjerin Ndreu sfidon kundërshtarët: Shihemi...

SEPTEMBER 17, 2026

Botoxi kontrabandë, Gremi i pandehur, çfarë...

SEPTEMBER 17, 2026

Besfort Lamallari u lirua nga detyra, presidenti...

SEPTEMBER 17, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu